



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE INFORMIMIT PUBLIK
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 210 Prot.

Patos, më 19 / 01 / 2026

RAPORT PËR DËGJESAT PUBLIKE PËR VITIN 2025
KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Procesi i Njoftimit dhe Konsultimit në Bashkinë Patos, gjatë vitit 2025, është bazuar në parimet mëposhme:

1. Transparencë gjatë procesit të njoftimit të konsultimit publik.
2. Pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese
3. Efektshmëri e procesit të vendimmarrjes në organet publike
4. Përgjegjësia e organeve publike ndaj palëve të interesura

Procesi i konsultimit është realizuar në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik” si dhe VKB-së nr. 88 datë 19.12.025, mbi “Miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së Projekt Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 dhe Projekt Buxhetit Vjetor për vitin 2026”.

Bashkia (Ekzekutivi) dhe Këshilli i Bashkisë kanë bashkërenduar për realizimin e një procesi konsultativ efikas duke optimizuar burimet në dispozicion. Sipas kalendarit vjetor të konsultimeve publike për vitin 2025 me nr. 171 Prot., datë 15.01.2025 si dhe kërkesave të drejtorive janë realizuar 26 dëgjesa publike me banorë të qytetit Patos, njërive Administrative Zharrëz dhe Ruzhdiqe dhe veçanërisht me të rinjtë. Të gjitha seancat e konsultimit publik janë pasqyruar në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Patos, në rrjetet sociale që ka në administrim Bashkia dhe Këshilli Bashkiak, si edhe në faqen e Website dedikuar Bashkisë Patos.

Ky raport vjetor hartohet nga Koordinator i konsultimit publik në Bashkinë Patos, në zbatim të detyrave që përcakton autoriteti publik, neni 20 i ligjit 146/ 2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ku sipas parashikimeve të këtij neni organet publike hartojnë dhe publikojnë raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes, ku përfshihet informacion për:

- a) Numrin e akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit referues
- b) Numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara
- c) Numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit
- d) Numrin e takimeve publike të organizuara

➤ **Numri i akteve të miratuar nga organi publik përkatës gjatë vitit 2025.**

Këshilli Bashkiak Patos, miratoj gjithsej 85 vendime gjatë vitit 2025, të cilat gjenden të publikuara në faqen dedikuar Bashkisë Patos në VENDIME.AL integruar në faqen zyrtare të Bashkisë Patos.

➤ **Numri i përgjithshëm i rekomandimeve të marra nga palët e interesuara:**

Gjatë procesit konsultativ janë regjistruar disa rekomandime të cilat lidhen me çështje të ndryshme në varësi të temës së diskutuar. Rekomandimet kryesore dhe më të rëndësishme që janë nxjerrë kanë të bëjnë me dokumentin e Buxhetit për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028 dhe Paketën Fiskale 2026. Gjithashtu janë regjistruar edhe rekomandime lidhur me të gjithë dëgjesat e tjera publik që kanë pasur të bëjnë me dokumente kryesre siç janë planet vendore. Çështjet kryesore të regjistruara në procesverbalet dhe raportet mbi dëgjesat publike lidhen me investime në infrastrukturën rrugore, shtrim i rrugëve të parcelave bujqësore, mirëmbajtja dhe investim në institucioneve arsimore, ofrimi i shërbimit të pastrimit, investime në ambiente argëtimi dhe shumë rekomandime të tjera. Rekomandimet e regjistruara lidhen me qytetin e Patosit, njësinë administrative Zharrëz, njësinë administrative Ruzhdie dhe veçanërisht me target grupin e të rinjve që i përkasin territorit të bashkisë Patos.

➤ **Numri i rekomandimeve e të komenteve të pranuarra dhe të refuzuara:**

Të gjitha rekomandimet e regjistruara në takimet konsultative të realizuara u mbajtën parashysh të arsyetuar nga ekzekutivi, i cili u angazhua në organizimin dhe drejtimin e dëgjesave publike.

➤ **Numri i takimeve publike të organizuara**

1. Dëgjesë publike në datë 16.04.2025 realizuar në Njësinë Administrative Zharrëz me procesverbal me nr. 767/6 prot., datë 18.04.2025, me temë **“Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e PBA-së 2026-2028”**.
2. Dëgjesë publike në datë 22.04.2025 realizuar në ambientet e Sallës së Këshillit Bashkiak Patos me procesverbal me nr. 767/7 prot., datë 24.04.2025, me temë **“Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e PBA-së 2026-2028”**.
3. Dëgjesë publike në datë 23.04.2025 realizuar në ambientet e Sallës së Këshillit Bashkiak Patos me të rinjtë, me procesverbal me nr. 767/8 prot., datë 28.04.2025, me temë **“Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e PBA-së 2026-2028”**.
4. Dëgjesë publike në datë 25.04.2025 realizuar në njësinë administrative Ruzhdie me procesverbal me nr. 767/9 prot., datë 28.04.2025, me temë **“Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e PBA-së 2026-2028”**.
5. Dëgjesë publike në datë 19.05.2025 realizuar në njësinë administrative Zharrëz me procesverbal me nr. 1124/7 prot., datë 22.05.2025, me temë **“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2026”**.
6. Dëgjesë publike në datë 20.05.2025 realizuar në sallën e Këshillit Bashkiak Patos me procesverbal me nr. 1124/8 prot., datë 22.05.2025, me temë **“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2026”**.

7. Dëgjese publike në datë 21.05.2025 realizuar në njësinë administrative Ruzhdie me procesverbal me nr. 1124/9 prot., datë 23.05.2025, me temë **“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2026”**.
8. Dëgjese publike në datë 15.07.2025 realizuar në sallën e Këshillit Bashkiak Patos me procesverbal me nr. 1789/1.1 prot., datë 16.07.2025, me temë **“Plani social 2025-2028”**.
9. Dëgjese publike në datë 16.07.2025 realizuar në sallën e Këshillit Bashkiak Patos me procesverbal me nr. 1789/3.1 prot., datë 17.07.2025, me temë **“Plani lokal i menaxhimit të integruar të mbetjeve 2025-2030”**.
10. Dëgjese publike në datë 16.07.2025 realizuar në sallën e Këshillit Bashkiak Patos me procesverbal me nr. 1789/5.1 prot., datë 17.07.2025, me temë **“Plani i mbarështimit të ekonomisë pyjore- Ana e Lumit Seman 2”**.
11. Dëgjese publike në datë 05.08.2025 realizuar në sallën e Këshillit Bashkiak Patos me procesverbal me nr. 2068/5 prot., datë 06.08.2025, me temë **“Plani i Barazisë Gjimore 2026-2028”**.
12. Dëgjese publike në datë 05.08.2025 realizuar në sallën e Këshillit Bashkiak Patos me procesverbal me nr. 2068/6 prot., datë 07.08.2025, me temë **“Plani i Arsimit Parauniversitar 2025-2027”**.
13. Dëgjese publike në datë 12.08.2025 realizuar në sallën e Këshillit Bashkiak Patos me procesverbal me nr. 2091/2 prot., datë 12.08.2025, me temë **“Plani vendor i Emergjencave Civile 2024-2030”**.
14. Dëgjese publike në datë 03.09.2025 realizuar në njësinë administrative Zharrëz me procesverbal me nr. 2362/6 prot., datë 04.09.2025, me temë **“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2026-2028”**.
15. Dëgjese publike në datë 08.09.2025 realizuar në njësinë administrative Ruzhdie me procesverbal me nr. 2362/7 prot., datë 09.09.2025, me temë **“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2026-2028”**.
16. Dëgjese publike në datë 09.09.2025 realizuar në sallën e Këshillit Bashkiak Patos me procesverbal me nr. 2362/8 prot., datë 11.09.2025, me temë **“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2026-2028”**.
17. Dëgjese publike në datë 10.09.2025 realizuar në sallën e Këshillit Bashkiak Patos me të rinjtë me procesverbal me nr. 2362/9 prot., datë 11.09.2025, me temë **“Rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2026-2028”**.
18. Dëgjese publike në datë 07.10.2025 realizuar në njësinë administrative Zharrëz me procesverbal me nr. 2710/6 prot., datë 08.10.2025, me temë **“Prezantimi përfundimtar i Paketës Fiskale 2026”**.
19. Dëgjese publike në datë 08.10.2025 realizuar në sallën e Këshillit Bashkiak Patos me procesverbal me nr. 2710/7 prot., datë 09.10.2025, me temë **“Prezantimi përfundimtar i Paketës Fiskale 2026”**.

20. Dëgjesë publike në datë 08.10.2025 realizuar në njësinë administrative Ruzhdie me procesverbal me nr. 2710/8 prot., datë 13.10.2025, me temë **“Prezantimi përfundimtar i Paketës Fiskale 2026”**.
21. Dëgjesë publike në datë 07.10.2025 realizuar në sallën e Këshillit Bashkiak Patos me procesverbal me nr. 2626/2 prot., datë 08.10.2025, me temë **“Plani 5-vjeçar i Strehimit Social 2025-2029”**.
22. Dëgjesë publike në datë 25.11.2025 realizuar në sallën e Këshillit Bashkiak Patos me procesverbal me nr. 3174/8 prot., datë 26.11.2025, me temë **“Prezantimi përfundimtar i Buxhetit për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”**.
23. Dëgjesë publike në datë 25.11.2025 realizuar në sallën e Këshillit Bashkiak Patos me të rinjtë, me procesverbal me nr. 3174/9 prot., datë 26.11.2025, me temë **“Prezantimi përfundimtar i Buxhetit për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”**.
24. Dëgjesë publike në datë 26.11.2025 realizuar në njësinë administrative Zharrëz, me procesverbal me nr. 3174/10 prot., datë 27.11.2025, me temë **“Prezantimi përfundimtar i Buxhetit për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”**.
25. Dëgjesë publike në datë 27.11.2025 realizuar në njësinë administrative Ruzhdie, me procesverbal me nr. 3174/11 prot., datë 27.11.2025, me temë **“Prezantimi përfundimtar i Buxhetit për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”**.
26. Dëgjesë publike në datë 05.11.2025 realizuar në sallën e Këshillit Bashkiak Patos, me procesverbal me nr. 3002/6 prot., datë 07.11.2025, me temë **“Vlerësimi strategjik mjedisor mbi Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**.
- Raport mbi fazën e parë të PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit 2026 ku janë pasyqur rekomandimet e marra në dëgjesat publike të realizuara, me nr. 1124/10 prot., datë 26.05.2025.
 - Raport mbi rezultatet e konsultimeve publike të prioritetëve të Komunitetit të Bashkisë Patos me nr. 2362/10 prot., datë 11.09.2025.
 - Raport mbi rezultatet e konsultimeve publike të Bashkisë Patos me nr. 3174/ 12 prot., datë 02.12.2025.

Të gjitha informacionet lidhur me dëgjesat publike gjenden të publikuara në faqen zyrtare të Website-it të bashkisë Patos.

Drejtori
Irisi Xhelaj
